

**ANALIZA  
E REZULTATEVE TË  
MONITORIMIT MBI  
INFORMIMIN NGA  
MEDIAT 2018**

Shkup, dhjetor 2018

Titulli:  
ANALIZA E REZULTATEVE TË MONITORIMIT MBI  
INFORMIMIN NGA MEDIAT 2018

Botues:  
NVO Infocentar, 2019

Autorë:  
Qendra për Komunikime Qytetare, BIRN,  
NVO Infocentar

Përktheu në gjuhën shqipe:  
Jordana Shemko

Tirazhi:  
50

CIP - Каталогизација во публикација

Национална и универзитетска библиотека "Св.  
Климент Охридски", Скопје

316.774/.776:005.584.1(497.7)(047)

ANALIZA e rezultateve të monitorimit mbi informimin  
nga mediat : 2018. - Shkup : NVO Infocentar, 2019. - 28  
стр. : граф. прикази ; 21x21cm

Фусноти кон текстот

ISBN 978-608-4594-19-2

а) Медиуми - Мониторинг - Македонија - Извештаи

COBISS.MK-ID 109351690

Ky publikim është përgatitur me ndihmë nga Bashkimi Evropian. Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi vetëm e Qendrës për Komunikime Qytetare, NVO Infocentar dhe BIRN Maqedonia dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet se i pasqyron pikëpamjet e Bashkimit Evropian.

# PËRMBAJTJA

faqe: 4



Hyrja

faqe: 12



Rezultatet e  
detajuara nga  
monitorimi

faqe: 6



Metodologjia

faqe: 26



Përfundimet

faqe: 10



Gjetjet  
kryesore

faqe: 28



Rekomandimet



# HYRJA

Monitorimi i mediave për vlerësim të cilësisë dhe sasisë së informimit hulumtues dhe analitik gazetaresk zbatohet në suazat e projektit “Gazetari hulumtuese për nxitje të reformave”, i financuar nga Bashkimi Evropian. Qëllimi i projektit, i cili po realizohet në periudhën 2016-2019, është nxitja e zhvillimit të gazetarisë së saktë dhe hulumtuese në drejtim të përmirësimit të informimit më të mirë të publikut dhe mbrojtjes së interesit publik. Me fjalë të tjera, qëllimi është që të nxiten redaksitë dhe gazetarët t’i përkushtohen analizës më të thellë dhe më thelbësore të problemeve duke u veçuar në mënyrë cilësore nga fluksi i informacioneve të shkurtra, të shpejta, sipërfaqësore dhe sensacionale, duke

u mundësuar qytetarëve kontekst dhe mbikëqyrje më të mirë në gjendjet.

Ky është monitorimi i tretë i mediave, pas atyre në vitin 2016 dhe 2017. Edhe këtë vit, monitorimi i ka përfshirë artikujt hulumtues dhe analitikë të botuar nga mediat, sepse gazetaria analitike nënkupton që t’u japë kuptim dhe t’i vendosë në kontekst temat shoqërore të komplikuar që t’i sqarohen publikut, kurse kështu kombinohen aspektet e gazetarisë hulumtuese dhe të informimit shpjegues.


Monitorimi ka për qëllim të sigurojë informacione të mjaftueshme, cilësore dhe relevante të cilat do të japin vlerësim të përfaqësimit dhe cilësisë së teksteve



gazetareske hulumtuese dhe analitike, si dhe të temave dhe fushave të cilat janë trajtuar në ato tekste.

Njëkohësisht, rezultatet e monitorimit të mediave duhet të shërbejnë mandej si bazë për ndërmarrjen e një sërë aksionesh në drejtim të përmirësimit të raportimit gazetaresk, në përgjithësi. Gazetarët dhe mediat mund të ndihmohen t'i identifikojnë anët e dobëta të informimit të deritanishëm dhe të jenë udhërrëfyes për përparimin e raportimit të tyre.

Organizatave joqeveritare, përsëri, kjo analizë mund t'ua tregojë fushat ku nevojitet angazhim më i madh në drejtim të informimit më të rregullt, më profesional dhe më objektiv të publikut.



# METODOLOGJIA

Metodologjia e monitorimit është vendosur dhe përpiluar, në mënyrë të tillë, që midis të tjerash të marrë përgjigje për këto pyetje kryesore që janë në vijim:

- Në çfarë mase përfaqësohen gazetaria hulumtuese dhe analitike në mediat e Maqedonisë?
- Si është cilësia e artikujve hulumtues dhe e teksteve analitike (në kuptim të përfshirjes së burimeve, përfaqësimit të palëve, përmbajtjes së elementëve: besueshmëri, relevancë, besim dhe kredibilitet etj.)?
- A janë ruajtur në këta artikuj dhe tekste standardet themelore profesionale të gazetarisë?
- Në cilat fusha përfaqësohen gazetaria dhe hulumtuese dhe analitike dhe ku mungojnë?

Bëhet fjalë për monitorim të teksteve gazetareske të cilat përfaqësojnë çfarëdo lloj forme të gazetarisë analitike dhe/ose hulumtuese, përkatësisht tekste të cilat nuk janë lajm, lajm i zgjeruar ose raport nga ndonjë eveniment.

Përzgjedhja e mediave, artikujt<sup>1</sup> e të cilave janë analizuar është bërë duke marrë parasysh gjendjen në media, qëllimet e këtij monitorimi, nevojat për analizë të rezultateve nga monitorimi, postulatet dhe vendosja e projektit, si edhe përvojën e mëparshme në këtë fushë. Gjatë kësaj është marrë parasysh mediat e përzgjedhura në ekzemplar të jenë tradicionale, relevante, të para/lexuara dhe përkatëse për monitorim, të jenë media përkatëse, të përfaqësuara, elektronike dhe të shtypura, media të cilat lexohen/shikohen në nivel nacional dhe lokal, në maqedonisht dhe në shqip dhe media me përkatësi pronësore dhe politike redaktore të ndryshme.

Prandaj, janë përzgjedhur këto dhjetë medie:

<sup>1</sup> Me fjalën e përbashkët “shkrime” nënkuptohen tekstet gazetareske në gazetat dhe revistat dhe informacionet e tjera në lajmet televizive.

- 1** RTM1 – televizioni nacional, shërbimi publik në gjuhën maqedonase;
- 2** Alsat M – televizioni nacional, në gjuhën shqipe;
- 3** Sitell – televizioni nacional, në gjuhën maqedonase;
- 4** Telma – televizioni nacional, në gjuhën maqedonase;
- 5** Tera TV – televizion rajonal nga Manastiri, në gjuhën maqedonase;
- 6** Nezavisen – gazeta ditore nacionale, në gjuhën maqedonase<sup>2</sup>;
- 7** Sloboden pečat – gazeta ditore nacionale, në gjuhën maqedonase;
- 8** Koha – gazeta ditore nacionale, në gjuhën shqipe;
- 9** Kapital – revista javore nacionale, në gjuhën maqedonase;
- 10** Fokus – revista javore nacionale, në gjuhën maqedonase.

<sup>2</sup> Në vitin 2016 dhe 2017, në monitorim ishte përfshirë gazeta “Dnevnik”, e cila nuk ndaloi të dalë nga shtypi në vitin 2017. Prandaj, në vitin 2018, në monitorim e përfshimë gazetën ditore “Nezavisen”.

Objekt i monitorimit të drejtpërdrejtë ishin shkrimet e botuar në këto periudha: 26 mars – 1 prill; 16-22 prill 3 dhe 7-13 maj<sup>4</sup> në vitin 2018.

Bëhet fjalë për kombinim të monitorimit cilësor dhe kuantitativ i cili si rezultat, përveç të dhënave numerike, jep edhe njohuri për cilësinë e artikujve të analizuar, në kuptim të ruajtjes së standardeve profesionale gazetareske.

Artikujt e botuar dhe përmbajtja e tyre, midis të tjerash, janë analizuar nga aspektet e mëposhtme:

- Përkatësia e shkrimit sipas zhanrit (hulumtim apo analizë);
- Fusha/tema të cilat përfshihen në artikuj;
- Faqja/pjesa e lajmeve ku është shpallur shkrimi;
- Rubrika ku është shpallur artikulli;
- Madhësia e artikullit;
- Paralajmërimi i artikullit në ballinë/forshpan;
- Ilustrimet në artikull;

<sup>3</sup> Për shkak të problemeve teknike, RTM1, Telma dhe Sitell janë përfshirë në periudhën nga 17 deri më 23 prill 2018.


<sup>4</sup> Për shkak të problemeve teknike, Telma është përfshirë në periudhën nga 7 deri në 12 maj, duke përfshirë edhe 14 majin 2018.

- Autori i artikullit;
- Numri, statusi dhe lokacioni i burimeve;
- Qasje e drejtë dhe e balancuar;
- Shkasi për artikullin;
- Konsultimi i palës së prekur dhe mënyra se si është transmetuar në këtë artikull etj.;
- Relevanca, paanësia, origjinaliteti etj.

**Objekti i analizës janë rezultatet e përmbledhura nga monitorimi dhe jo rezultatet e veçanta nga cilido prej mediave të përfshira.**







# GJETJET KRYESORE

- Në vitin 2018 është vënë re përqindja më e lartë e artikujve hulumtues në krahasim me dy vitet e mëparshme.
- Ndërsa në vitin 2016 kishte vetëm 0,4%, kurse në vitin 2017 kishte 0,8%, numri i artikujve hulumtues është zmadhuar në 2%.
- Më tepër analiza dhe hulumtime ka për politikën, ekonominë dhe gjyqësorin, kurse është vënë re edhe zmadhim i përmbajtjeve të cilat janë për mjedisin jetësor dhe urbanizmin.
- Më tepër se gjysma (57%) e teksteve/artikujve analitikë-hulumtues janë paralajmëruar në ballinat dhe në lajmet kryesore (vjet 53%).
- Me fotografi dhe xhirime origjinale janë ilustruar 35% e teksteve/artikujve, kjo është përqindja më e lartë deri më sot.
- Shumica e teksteve/artikujve janë nënshkruar me emrin dhe mbiemrin e autorit.
- Është zmadhuar numri i përmbajtjeve të nxitura nga “pseudo evenimente” (konferenca për shtyp, shpallje, deklarata etj.).
- U zvogëluar numri i përmbajtjeve hulumtuese-analitike shkas i të cilave është hulumtimi i pavarur i gazetarëve.
- Është zmadhuar numri i artikujve me tri apo më tepër burime informacionesh.
- Këtë vit, për herë të parë, dominojnë tekste dhe artikuj ku janë konsultuar më tepër faqe – 42%.
- Në shumicën e përmbajtjeve, burimet e informacioneve janë dhënë, kurse nuk ka artikuj ku burimet janë vetëm anonime.



- Numri i përmbajtjeve ku nuk është konsultuar pala e prekur edhe mandej është e lartë dhe përbën 51%.
- Institucionet shtetërore janë burimi i vazhdueshëm më i përfaqësuar në informacione.
- Për dallim nga viti 2016 dhe 2017, kur pjesëmarrja e qeverisë si burim i informacioneve lëvizte nga 0 deri në 1%, ajo merr pjesë me 6%.
- Në vend të dytë si burim i informacioneve janë ekspertët universitarë me 9,5% kurse në vend të tretë dhe të katërt janë partitë politike (9%) dhe sektori qytetar (8%).
- Është zmadhuar numri i përmbajtjeve ku janë dhënë dokumente ose në të cilat nënkuptohet se gazetari posedon dokumente si vërtetim për pohimet e shpallura.

# IV


## REZULTATET E DETAJUARA NGA MONITORIMI

**“Përqindja më e lartë e artikujve hulomtues në tri vitet e fundit.”**

Në periudhën e monitorimit, në dhjetë mediat e mbikëqyra, janë regjistruar 183 artikuj dhe tekste gazetareske gjithsej me karakter hulomtues-analitik. Ky numër është 11,7% e numrit të përgjithshëm të materialeve të shtypura (1565) dhe shënon një linjë në rritje, si në krahasim me vitin 2017 – 9% ashtu edhe në krahasim me vitin 2016 – 5%.


Prerja e detajuar kuantitative dëshmon se në krahasim me dy vitet e mëparshme, është zmadhuar theksueshëm edhe përqindja e teksteve dhe artikujve hulumtues. Ndërsa në vitin 2016 ka pasur vetëm 0,4%, kurse në vitin 2017 0,8%, në vitin 2018, numri i artikujve hulumtues u zmadhua në 2% nga numri i përgjithshëm i përmbajtjeve në mediat e analizuara. Gjithsesi, “më vete” kjo nuk përfaqëson një përqindje të lartë, por është tregues i rëndësishëm për faktin se mediat gjithnjë edhe më tepër në vazhdimësi e njohin nevojën për krijim dhe botim të produkteve hulumtuese gazetareske.

### Përfaqësimi i artikujve analitikë dhe hulumtues



- Artikuj hulumtues
- Analiza
- Artikuj të tjerë

### Përfaqësimi i artikujve hulumtues (sipas viteve)




Si edhe në dy vitet e kaluar, ashtu edhe në vitin 2018, pjesa më e madhe përmbajtjeve hulumtuese-analitike janë botuar në rubrikën “Maqedonia” (36%) dhe Aktuale (23,5%), kurse pastaj vijojnë rubrika “Ekonomia” me 11% dhe rubrika “Analiza” me 5%.

**Më tepër analiza dhe hulumtime ka për politikën, ekonominë dhe gjyqësorin.**

Analiza kualitative e përmbajtjeve mediatike dëshmoi se temat më të përfaqësuar në artikujt hulumtues-analitikë janë politika (27%) dhe ekonomia (19%). Por kësaj radhe atyre u janë bashkangjitur gjyqësori me 11% dhe shëndetësia me 8%. Gjithashtu, në krahasim me vitet e mëparshme, është vënë re edhe zmadhim i përmbajtjeve të cilat kanë të bëjnë me mjedisin jetësor dhe urbanizmin.

Artikujt hulumtues-analitikë të botuar në media edhe mandej janë të inspiruar kryesisht nga ndodhitë e përditshme politike. Këtë konstatim e mbështet edhe fakti se përqindja e artikujve hulumtues-analitikë kushtuar gjyqësorit është zmadhuar pikërisht në vitin të cilin e karakterizojnë procese të shumta gjyqësore të nxitura nga Prokuroria Speciale Publike, por edhe nga Prokuroria Publike e Republikës së Maqedonisë.

**Përfaqësimi i temave**



**Vazhdon trendi i teksteve dhe artikujve shumë të gjatë hulumtues-analitikë.**

Sipas madhësisë, madje 44,5% e përmbajtjeve hulumtuese-analitike janë shumë të gjata (në një apo më tepër faqe në mediat e shtypura dhe më të gjata se 2:10 minuta në televizione), 43% janë të gjata

(nga gjysmë faqe deri në një faqe të tërë në mediat e shtypura dhe deri 1:40 minuta në televizione), kurse vetë 1% janë artikuj të shkurtës.

Shpërndarja e tillë e gjatësisë, përkatësisht minutazhit, padyshim që dëshmon se mediat i vlerësojnë përmbajtjet hulumtuese dhe analitike dhe për to veçojnë hapësirën dhe kohën përkatëse.


**Shumica e teksteve/ artikujve analitikë-hulumtues janë paralajmëruar në faqet e para dhe në lajmet kryesore.**

Numri i përmbajtjeve hulumtuese të paralajmëruara në faqen e parë dhe në lajmet kryesore është 57% dhe kjo përqindje në krahasim me vitin 2017 është më e lartë për 4 përqind, kurse në krahasim me vitin 2016 për mbi 11 përqind.

Si edhe në vitet e mëparshme, ashtu edhe në vitin 2018, mediat e shtypura i paralajmërojnë më tepër artikujt hulumtues-analitikë, në krahasim me televizionet, por tani, për herë të parë, numri i përmbajtjeve


me titull dhe një pjesë të tekstit është më i madh sesa artikujt e paralajmëruar vetëm me titull.

### A është paralajmëruar teksti në ballinë dhe në lajmet kryesore?



- Nuk është paralajmëruar
- Po (TV)
- Po gazetë - vetëm titull
- Po (gazetë - në faqen e parë dhe një pjesë e tekstit)

## Tekste të parala-jmëruara në ballinë dhe në lajmet kryesore (sipas viteve)




Trendet e zmadhimit të vazhdueshëm të përmbajtjeve hulumtuese-analitike të cilat parala-jmërohen në ballinë dhe në lajmet kryesore, përfaqëson një indikator për faktin se mediat gjithnjë edhe më shumë e dallojnë kontributin e tyre në mbrojtjen dhe promovimin e interesit publik.

“ Numër i zmadhuar i përmbajtjeve të ilustruara me fotografi dhe xhirime autentike. ”

Me fotografi dhe xhirime origjinale janë ilustruar 35% e teksteve/artikujve dhe kjo është përqindja më e madhe deri më sot (viti 2016 – 21,6%, viti 2017 – 26%). Numri i teksteve dhe artikujve të cilët nuk kanë asnjë xhirim apo fotografi është vetë 4%. Përkeqësim të vetëm në krahasim me vitin 2017 ka te tekstet dhe artikujt hulumtues-analitikë të shoqëruar me fotografi dhe xhirime të përgjithshme apo tematike. Ndërsa vjet përmbajtje të tilla kishte 51%, këtë vit numri i tyre është zmadhuar në 61%.




### Fotografi/xhirime të artikujve



- Jo
- Po (fotografi/xhirim i përgjithshëm për temën, por jo nga ngjarja)
- Po (ka fotografi/xhirime origjinale nga ngjarja)

### Përmbajtje me fotografi dhe xhirime autentike (sipas viteve)



Përqindja e zmadhuar e teksteve me ilustrime autentike dhe numri i zvogëluar i përmbajtjeve pa asnjë lloj fotografish apo xhirimesh, është një trend nxitës, sepse, çdo artikull analitik-hulumtues duhet të mbështetet me sa më shumë xhirime dhe ilustrime origjinale që të ketë mundësi. Në këtë mënyrë përmirësohet cilësia dhe relevanca e artikujve, por përforcohet edhe interesi i publikut/opinionit.т на публикаата / јавноста.

**Shumica e teksteve/artikujve janë të nënshkruar me emrin dhe mbiemrin e autori.**


Edhe këtë vit, një përqindje e lartë 89% e teksteve hulumtuese-analitike janë nënshkruar nga autorët, kurse vetëm 1,5% janë anonime. Autori është nënshkruar me initiale në 5% të përmbajtjeve, kurse 4,5% e teksteve të analizuara janë marrë nga një medie tjetër.

Përqindja e lartë konstante e teksteve dhe artikujve të nënshkruar, si dhe zvogëlimi i numrit të përmbajtjeve anonime, e përforcon kredibilitetin e mediave si dhe besimin te qytetarët.

**Numër i zmadhuar i përmbajtjeve të nxitura nga “pseudo evenimente”.**

Analiza e përmbajtjeve mediatike dëshmon se për 46% të teksteve dhe artikujve analitikë-hulumtues, shkas ka qenë ndonjë “pseudo eveniment” (konferencë për shtyp, shpallje, deklaratë, seancë etj.) Në vitin 2016 numri i përmbajtjeve të tilla ka qenë 26%, kurse në vitin 2017, 31%.


### Artikuj të nxitur nga pseudo evenimente (sipas viteve)



- Artikuj sipas pseudo evenimenti në vitin 2018
- Artikuj sipas pseudo evenimenti në vitin 2017
- Artikuj sipas pseudo evenimenti në vitin 2016

Ajo që shqetëson është zvogëlimi i numrit të përmbajtjeve hulumtuese-analitike shkas i të cilave është hulumtimi i pavarur nga gazetarët. Këtë vit numri i artikujve të tillë gazetareskë është 22% dhe është më i vogël në krahasim me dy vitet e mëparshme (viti 2016 – 24%, viti 2017 – 31%).

### Shkas për artikullin




Zmadhimi i numrit të teksteve dhe artikujve të nxitur nga “pseudo evenimente”, kurse zvogëlimi i atyre që janë rezultat i vetiniciativës së gazetarëve, dëshmon se mediat ende i njohin pak nevojat dhe interesat e qytetarëve dhe se një pjesë e madhe e përmbajtjeve janë “imponuar” nga qendra të ndryshme të fuqisë politike, ekonomike etj.

**Përqindje e zmadhuar e artikujve me tri dhe më tepër burime informacionesh.**


Pjesa më e madhe e përmbajtjeve hulumtuese-gazetareske përmbajnë tri apo më tepër burime informacionesh (55%). Kjo është përqindja më e lartë deri më tani. Në vitin 2016 numri i artikujve me më tepër burime ishte 54%, kurse në vitin 2017, 41%.

### Artikuj me tri ose më shumë burime (sipas viteve)



Numri i artikujve gazetareske ku nuk ka asnjë burim informacionesh, këtë vit, është 7%, kurse në vitin 2016 përqindja për artikuj të tillë ishte 9%, kurse në vitin 2017 është 5%. Në vitin 2018, u zvogëlua përfaqësimi i artikujve me vetëm një burim informacionesh – 15%.

## Burim informacionesh




Zmadhimi i numrit të artikujve analitikë-hulumtues me më tepër burime dhe zvogëlim të atyre të cilat kanë vetëm një burim, padyshim çon në përmirësim të cilësisë të produkteve gazetareske të cilat mediat ua dedikojnë qytetarëve. Lloji i burimeve, numri i tyre dhe kredibiliteti i tyre janë me rëndësi të veçantë për punën hulumtuese-analitike të gazetarëve sepse nga cilësia e burimeve dhe informacionet e marrë varet në masë të madhe edhe relevanca e artikujve hulumtues dhe analitikë.

**“Përqindje e lartë e artikujve ku janë vendosur burimet e informacioneve.”**

Në shumicën e përmbajtjeve të analizuara (67%), burimet e informacioneve janë dhënë, kurse enë 27% ka edhe burime anonime edhe burime të dhëna. Është interesante të përmendet se nuk ka artikull ku burimet janë tërësisht anonime.

## Statusi i burimeve




- Të dhëna
- Të dhëna dhe anonime
- Nuk ka burime

Trendi i tillë i emërimit të burimeve është me rëndësi të veçantë për relevancën dhe besueshmërinë e teksteve hulumtuese gazetareske.


**Numër i zmadhuar i teksteve/artikujve të cilët janë konsultuar më tepër se dy palë.**

Për dallim nga dy vitet e mëparshme, këtë vit për herë të parë, dominuan tekstet dhe artikujt ku janë konsultuar më tepër palë – 42%. Në 27% të përmbajtjeve gazetarët kanë konsultuar dy palë, kurse në 23% kanë përfshirë vetëm një palë.

Palët në burime



### Artikuj ku konsultohen më tepër palë (sipas viteve)



Zmadhimi i përqindjes së përmbajtjeve ku konsultohen dy dhe më tepër palë, ndikon pozitivisht mbi paanësisë, cilësisë dhe kredibilitetit të gazetarëve dhe produkteve të tyre finale.


**Në shumicën e teksteve/artikujve nuk është konsultuar pala e prekur.**

Edhe këtë vit numri i përmbajtjeve ku nuk është konsultuar pala e prekur është e lartë 51%. Në vitin 2017 kjo përqindje ka qenë 55%. Përmirësim i vogël është vënë re edhe tek artikujt ku pala e prekur është konsultuar

dhe ka dhënë deklaratë. Këtë viti përqindja është 43%, kurse vjet ka qenë 40%. Në 6% të teksteve/artikujve, pala e prekur është konsultuar, por nuk ka dhënë deklaratë.

Përfshirja e të gjitha palëve të prekura në tekstet/artikujt është një nga elementët themelorë të gazetarisë profesionale dhe të paanshme. Përqindja e lartë e përmbajtjeve ku nuk është konsultuar pala e prekur përbën problem serioz për objektivitetin, besueshmërinë dhe kredibilitetin, si të gazetarëve ashtu edhe të vetë mediave.

#### A është konsultuar pala e prekur?




- Nuk është konsultuar
- Është konsultuar, por nuk ka dashur të japë deklaratë
- Është konsultuar dhe ka dhënë deklaratë (e cituar ose e parafrazuar)


**Institucionet shtetërore janë vazhdimisht burimi më i përfaqësuar i informacioneve.**

Si edhe në vitet e mëparshme, ashtu edhe në vitin 2018, burimi i përfaqësuar i informacioneve janë institucionet (ministria, qeveria, institucionet shtetërore të papërmendura) me 32%, që përbën përqindjen më të lartë të pjesëmarrjes (2016 – 23%, 2017 – 24%). Për dallim nga viti 2016 dhe 2017, kur pjesëmarrja e qeverisi si burim i informacioneve lëvizte nga 0 deri 1%, ajo merr pjesë me 6%.

### Institucionet shtetërore si burimi më i përfaqësuar i informacioneve (sipas viteve)




### Sektori qytetar si burim i informacioneve (sipas viteve)



Në vend të dytë janë ekspertët universitarë me 9,5%, kurse në vendin e tretë dhe të katërt janë partitë politike (9%) dhe sektori qytetar (8%).

### Lokacioni i burimeve



Zmadhimi i pjesëmarrjes së institucioneve shtetërore si burime të informacioneve për artikujt analitikë dhe hulumtues, nga njëra anë, nënkupton se ato po bëhen më të hapur dhe më transparentë, por nga ana tjetër, dëshmon se gazetarët preferojnë informacionet t'i marrin nga qendrat e fuqisë politike, përkundrajt publikut qytetar


dhe të pavarur. Këtë konstatim e mbështet edhe fakti se partitë politike, si burim i informacioneve janë ngjitur në vendin e tretë. Preferenca e tillë e gazetarëve ndaj institucioneve shtetërore dhe partive politike, balançohet vetëm pjesërisht me ekspertët universitarë dhe organizatat qytetare, si burim relevant, i besueshëm dhe kredibil i informacioneve.

“**Është zmadhuar numri i përmbajtjeve në të cilat pasqyrohen dokumente apo në të cilat kuptohet se gazetari posedon dokumente për të vërtetuar pohimet e dhëna.**”

Në 31% të përmbajtjeve nënkuptohet se gazetari ka dokumente, por ato nuk janë dhënë në tekst, kurse në 7% të teksteve autorët i kanë dhënë edhe dokumentet për pohimet e thëna. Këto përqindje në

krahasim me vitin 2017 janë më të larta, por megjithatë, nuk janë të mjaftueshme, sidomos kur bëhet fjalë për artikuj ku janë botuar dokumente si dëshmi për pohimet e dhëna nga gazetarët apo palët e prekura.


### Dokumente për vërtetim të hulumtimit/ analizës



- Ka dhënë dokumente
- Nënkuptohej se gazetari posedon/ka parë dokumente, por nuk janë treguar
- Nuk mund të vlerësojmë/Nuk është relevante



## Artikuj ku pasqyrohen dokumente ose nënkuptohet se gazetari posedon dokumente, por nuk janë vendosur (sipas viteve)



Megjithatë, dokumentet janë mjaft të rëndësishëm në aspektin e besueshmërisë dhe relevancës së artikujve, sepse, vetëm në këtë mënyrë gazetarët dhe mediat do të jenë bindës dhe do ta zmadhojnë besimin e qytetarëve ndaj punës së tyre. Njëkohësisht, kjo nënkupton edhe nxitje që palët e prekura të përfshihen në mënyrë më aktive në hulumtimet e gazetarëve dhe të japin kontribut më të madh me dokumente, qëndrime dhe mendime shtesë.

# V

Rezultatet e hulumtimit të mediave në vitin 2018, në raport me dy vitet e mëparshme, lënë hapësirë për optimizëm – gazetaria hulumtuese në mediat e Maqedonisë njihet si mjet i rëndësishëm në plotësimin e misionit të gazetarisë.

Përfaqësimi i hulumtimeve gazetareske në mediat e Maqedonisë është zmadhuar pesë herë në raport me vitin 2016 kur është zbatuar monitorimi i parë. Më shumë se gjysma e teksteve/artikujve analitikë-hulumtues janë paralajmëruar në ballina apo në lajmet kryesore.

Për dallim nga dy vitet e mëparshme, për herë të parë këtë vit monitorimi dëshmoi se dominojnë tekste në të cilat janë konsultuar më tepër palë, në shumicën e përmbajtjeve janë cituar burimet, po zmadhohet numri i përmbajtjeve ku jepen edhe dokumentet, kurse tashmë nuk ka më artikuj ku burimet janë vetëm anonime.

# PËRFUNDIME

Na nxit edhe fakti se po rritet përqindja e ilustrimeve në artikuj me fotografi origjinale, si dhe se shumica e teksteve përkatësisht artikujve janë nënshkruar me emrin dhe mbiemrin e autorit.

Megjithatë, monitorimi dëshmoi edhe disa tendenca të tjera jo dhe kaq pozitive kur bëhet fjalë për përmbajtjet hulumtuese dhe analitike në mediat në Maqedoni. E dhëna se për dallim nga viti 2016 dhe 2017, kur Qeveria ka marrë pjesë në mënyrë minimale si burim në artikujt gazetaresk (nga 0% deri në 1%), tani ajo merr pjesë me 6%, është shkak për alarm në redaksitë të cilat duan ta ruajnë integritetin dhe pavarësinë e vet. Këtë e dëshmon e dhe e dhëna se po ulet numri i artikujve shkasi i të cilëve është hulumtimi i pavarur gazetaresk, kurse po zmadhohet numri i përmbajtjeve të cilat janë rezultat i “pseudo evenimenteve (konferenca për shtyp, shpallje, seanca etj.).

Zmadhimi i pjesëmarrjes së institucioneve shtetërore si burime të informacioneve për artikujt analitikë dhe hulumtues, nga njëra anë, nënkupton se ato po bëhen më të hapura dhe më transparente, por nga ana tjetër, dëshmon se gazetarët preferojnë informacionet t'i marrin nga qendrat e fuqisë politike, përkundrejt publikut qytetar dhe të pavarur. Këtë konstatim e mbështet edhe fakti se partitë politike, si burim informacionesh janë ngritur në vendin e tretë.

Preferenca e tillë e gazetarëve ndaj institucioneve shtetërore dhe partive politike, e cenon integritetin dhe reputacionin e mediave.

Gjithashtu është anë negative edhe e dhëna se numri i përmbajtjeve ku nuk është konsultuar pala e prekur edhe mandej është i lartë, që në rend të ditës e mban të hapur çështjen për objektivitet, besueshmëri dhe kredibilitet, si për gazetarët ashtu edhe për vetë mediat.

E gjithë kjo dëshmon se paralelisht me nevojën për zmadhimin e përfaqësimit të gazetarisë hulumtuese dhe analitike në redaksi, ekziston domosdoshmëri edhe për përmirësim të respektimit të standardeve profesionale gazetareske siç është raporti i balancuar dhe i drejtë përkundrejt palëve

në artikull, përkatësisht konsultim dhe prezantim të të gjitha palëve me qasje të barabartë dhe të paanshme.

Për shkak të përgjegjësisë të cilën mediat e kanë para opinionit, por edhe për shkak të besimit dhe legjitimitetit të tyre shumëvjeçar, me rëndësi të madhe është të kujdesen jo vetëm për atë së hulumtojnë dhe analizojnë, por edhe si e kryejnë këtë.

Gjetjet e monitorimit të mediave dëshmojnë se edhe këtë vit, më tepër analiza dhe hulumtime ka mbi temat e ekonomisë dhe politikës, që nënkupton se pjesa më e madhe e teksteve kanë tema që lidhen dhe janë nxitur nga ngjarjet aktuale politike. Si temë dominon gjyqësori, kurse është vënë re rritje e përmbajtjeve të cilat lidhen me mjedisin jetësor dhe urbanizmin, që dëshmon se “interesi publik” dalëngadalë po bëhet kriter relevant për politikën redaktore.

# VI

## REKOMANDIME

- Përmirësim i cilësisë dhe kredibilitetit, si në gazetarinë ditore ashtu edhe në atë analitike dhe hulumtuese në interes të publikut dhe të mirës së përgjithshme, është sfidë e vazhdueshme me të cilën ballafaqohet çdo redaksi.
- Mediat duhet të vazhdojnë të zgjerojnë diapazonin e temave për hulumtim dhe analizë, edhe përkrah temave të cilat dali nga ngjarjet ditore politike, të përfshijnë edhe fusha të tjera të cilat janë me rëndësi të jashtëzakonshme për qytetarët dhe për interesin publik, siç janë: standardi jetësor, papunësia, korrupsioni, mjedisi jetësor, migrimet, drejtësia etj.
- Redaktorët duhet ta nxitin vetiniciativën gazetareske në llogari të ndjekjes “së verbët” të institucioneve qytetare si burim dominues.
- Redaksitë duhet të miratojnë praktika të mira për trajnim dhe përforsim të kapaciteteve hulumtuese dhe analitike të gazetarëve të vet. Investimi strategjik në trajnimin e gazetarëve është hap i domosdoshëm për mediat.
- Mediat të kenë më tepër resurse (njerëz, pajisje etj.) në prodhimin gazetaresk. Zvogëlimi i numrit të vendeve të punës dhe cilësia e pajisjeve nënkupton zvogëlim të numrit të artikujve hulumtues të cilët janë me rëndësi të madhe në luftën kundër korrupsionit dhe krimit.
- Është i domosdoshëm komunikimi dhe bashkëpunimi më i madh sesa konkurrenca në industri. Kjo nënkupton realizim të përbashkët të artikujve të caktuar hulumtues, si edhe botim dhe ndërmarrje të teksteve dhe temave me interes më të gjerë publik me citim të rregullt.
- Organizatat joqeveritare duhet të praktikojnë, informacionet të cilat i hasin gjatë punës së vet t’ua vënë në dispozicion gazetarëve, në një format të hapur dhe t’u japin mbështetjen e nevojshme gazetarëve gjatë hulumtimit dhe informimit mbi tema të cilat janë të rëndësishme për qytetarët.